



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHETIT

**N J O F T I M**

**PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR TË MATURANTËVE NË KUADËR TË PRANIMIT NË  
PROGRAMIN MJEKËSI E PËRGJITHSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË**

Ju bëjmë me dije se duke filluar nga data 14.08.2023, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), do të zhvillohet testimi i informatizuar i maturantëve, në kuadër të pranimit në programin Mjekësi e Përgjithshme në Universitetin e Mjekësisë Tiranë.

Në vijim, do të publikohet kalendari i organizimit të testimit dhe oraret përkatëse për kandidatët e regjistruar.

1. Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:

- Kartë ID ose Pasaportë (dokumenti origjinal);
- Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
- Faturën origjinale të pagesës (me vulën e bankës përkatëse) së tarifës së testimit për llogari të QSHA-së. Formularin për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në linkun:  
[http://qsha.gov.al/DPSH/materiale/fatura/Fature\\_provime\\_digjitalizuar.pdf](http://qsha.gov.al/DPSH/materiale/fatura/Fature_provime_digjitalizuar.pdf)

***Kandidatët, të cilët nuk paraqesin dokumentet e mësipërme, nuk mund të marrin pjesë në testim.***

2. Kandidati gjatë zhvillimit të testimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të testimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e testimit;
- ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e testimit;
- firmos procesverbalin e pjesëmarrjes dhe rezultatit të marrë.

Të gjithë kandidatët e regjistruar, lutemi të verifikojnë paraprakisht identitetin dhe orarin e pjesëmarrjes në testim, në faqen zyrtare të QSHA-së, në adresën [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al), “Provimet e Shtetit”, rubrika “Njoftime”, “Lista e kandidatëve për testimin e informatizuar, në kuadër të pranimit në programin Mjekësi e Përgjithshme.

**Në lidhje me orarin e pjesëmarrjes në testim, ju bëjmë me dije se orari do të jetë i përcaktuar për çdo kandidat dhe nuk do të ketë ndryshime orari përtej planifikimit të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së.**

*Ju urojmë suksese!*